

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Shqipe Qerimi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Bujar Ahmeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve H.K. nga fshati ..., komuna e Gjilanit, F.R. nga Ferizaji dhe M.H. nga Ferizaji, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 31. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit H.K., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.306/2016 të datës 23.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit H.K., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.306/2016 të datës 23.03.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin, P.nr.306/2016 të datës 23.03.2017, të akuzuarit H.K., F.R. dhe M.H. nga Ferizaji, i ka shpallur fajtorë për shkak se kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 31. Të KPRK për të cilën gjykata iu ka shqiptuar që të treve dënim me gjobë në shumë prej nga 300 (tre qind)€, e të cilin dënim janë të obliguar që ta paguajnë në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit si dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej nga 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Nëse të akuzuarit, dënimin me gjobë nuk e paguajnë në afatin e caktuar, atherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, ku për një ditë burgu do të llogarisë 20 € të dënimit me gjobë. Të akuzuarit janë obliguar që të paguajnë secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej nga 20€, si dhe taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit në shumë prej nga 30 €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nënë kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari H.K. për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë të aprovojë ankesën si të bazuar dhe ndaj të akuzuarit të shqiptojë dënim më të butë.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.476/2018 datë 08.05.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit H.K. dhe aktgjykimi i ankimuar, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 21.03.2018 e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimin të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, me ankesë i akuzuari Hevzi pretendon se dënimi i shqiptuar nuk përkon me veprën e kryer penale dhe se të akuzuarit i është shqiptuar dënimi i lartë duke pasur parasysh se i njëjti ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje, ka kërkuar falje për veprën e kryer si dhe ka premtuar se të njëjtën më nuk do ta përsërisë. Sipas ankesës, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, është dashur të ketë parasysh se i akuzuari Hevzi është mbajtës i vetëm i familjes dhe atë të fëmiut nëntë muajsh i cili ka nevojë për përkujdesje prindërore, e që me mbajtjen në institucion korrektues të të akuzuarit, të njëjtit do ti cenohej seriozisht mbijetesa ndërsa duke qenë në gjendje jo të mirë ekonomike, i njëjti me pagesën e shumës së shqiptuar prej 800 €, si zëvendësim i dënimit me burg, përsëri do të rrezikonte mirëqenien ekonomike të familjes.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e Prokurorit për shqiptimin e një dënimi me burg efektiv, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 të KPPK-së, me ç' rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar pranimin e fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese, pendimin e sinqertë, se është prind i tre fëmijëve, mbajtës i familjes, se më parë nuk ka qenë i dënuar ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtillë të rrethanave relevante të vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, duke aplikuar dispozitën e nenit 73 të KPPK, duke vlerësuar faktin se në ankesën etë akuzuarit H.K. nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale,

posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, e duke pasur parasysh se i akuzuari është gjykuar me dënim me kusht që do të thotë se të njëjtit nuk do ti cenohet mbijetesa me shkuarje në mbajtje të dënimit, nëse në afatin e caktuar të verifikimit nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale dhe se nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk i është bërë zëvendësi i dënimit me burg në dënim me gjobë, siç pretendon ky i akuzuar në ankesë, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.469/18 me datë 15.05.2018

Zyrtari ligjor
Bujar Ahmeti

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
1. Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

- 2. Shqipe Qerimi**
- 3. Afrim Shala**